[Shqiptarja.com]

E shtunë 22 Qershor 2024 - Përditësimi i fundit 18:25

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME | EDICIONET LOKALE | KRONIKË | POLITIKË | SHËNDETI | EKONOMI | SPORT | KOSOVË & RAJONI | BOTË | KULTURË | EDITORIAL | OPINION

TË FUNDIT | SOCIALE | DREJT PUNËS | SPECIALE | LIFESTYLE | VIP & SPEKTAKËL | RECETA | HOROSKOPI | DOLJE | FOTOGALERI | VIDEOGALERI | PMË E ZEJË | SONDAZHE

EURO 2024

POP 5 Lexojë më 5 minuta e 5 minutat e fundit

1 Dua Mulliqi kaqar pë vëllezërit e pagrisur krejtësisht nëpër shtëpi

2 Pisatë dha pikëmsë Rrjetin radial e Shqipërisë, ku do bëhet, cagaku i ri metakrom pasaform

3 Kualifikimi i fitojnë

4 Euro 2024/ Gjermania bëhet kundër Francës, ja kush janë "ta barrës" e

5 Skenat mashtruese me trikimin e numrave "fitues" nga "mashtruesit", ikuna kërcënojë qytetarët dhjetëra, dëmnësi kushtet e keqja ka krisur

6 Vaksinë nga Italia ka dërguar e gjashtë javë parë e dërgoja

Kronikë

Elbasan/ Zbulohet baza e armëve në Peqin, pranga anëtarit të një grupi kriminal! I fshihte në ambientet e biznesit (EMRI+ FOTO)

Një 43-vjeçar është arrestuar në Peqin pasi posedonte pa leje armë dhe municione.

Në servisin e babait të tij u gjet arma që vrau Emiljano Ramazanin

HOROSKOPI

RAPORTO Chat live me Shqiptarja.com

Qëndroni

Redaksia
21 Qershor, 00:01 | **Përditësimi: 22 Qershor, 00:44**

Share

Elbasan- Manahasët e Elbasanit dalin sërish në skenë. Pas një hetimi disa javor policia arriti të zbulojë aktivitetin e paligjshëm. Të një 43-vjeçari, që në ambientet e disa bizneseve të tij buzë lumit Shkumbini në Peqin kishte fshehur armatime pa leje.

Imer Manahasa, nga Peqini u arrestua në flagrancë ndërsa agjentët e krimeve të Policisë së Elbasanit i sekuestruan një pistoletë, një armë gjahu me fishekë, një pushkë sportive, një predhë të njëtër, thika, kokainë dhe 2 traga automjeti false.

Armët dhe sendet e paligjshme u gjetën të fshehura në disa ambiente në pronësi të tij, një pikë inertesh, varrezë makinash dhe stallë bagëtish. Më tej, shërbimet e Policisë zbuluan se Manahasa kishte ndërtuar një objekt, pa leje ku u zbulua se kishte të punësuar persona të padeklaruar.

LEXO EDHE:
Turizëm dhe traditë! Turi i folkut "ndez" me këngë e valle Elbasanin

'Bazuar në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, për një 43-vjeçar që posedonte pa leje, në ambientet e biznesit në pronësi të tij, armë zjarri, armë gjahu, municion luftarak, si edhe lëndë narkotike, shërbimet e Policisë kanë ndërhyrë në disa ambiente (pikë inertesh, varrezë makinash, stallë bagëtish) ku si rezultat kanë gjetur të fshehura: 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë gjuetie, 1 armë sportive, municion luftarak, 1 predhë, 1 thikë, një sasi lëndë narkotike kokainë dhe 2 traga automjeti false, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, informoi më 21 qershor 2024 policia e Elbasanit .

Bëhet fjalë për gurore dhe ndërtime të tjera në shërbim të saj.

Arrestimi i 43 vjeçarit Imer Manahasa u krye në kuadër të operacionit 'Katërkëndëshi' për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit", "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të fshehta", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive", "Punësimi i paligjshëm", "Ndërtimi i paligjshëm" dhe "Falsifikimi i vulave, i stampave ose formulareve"

Hetimi, thonë burimet, është i zgjeruar dhe po verifikohen persona të tjerë, pjesë e grupit kriminal. Për këtë rast, njofton zyrtarisht policia, kanë qenë disa të shoqëruar.

Imer Manahasa rezulton të jetë djali i Alber Manahasës, dhe vëllai i Seit Manahasës,të cilët më 28 korrik 2020 u arrestuan pasi në ambientet e biznesit të tyre, një servis makinashu gjet arma me të cilin u ekzekutua ***Emiljano Ramazani*** më 20 korrik 2020

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:03

Sundimi i ligjit, Balla: Vijon me sukses goditja e fenomenit të armëmbajtjes pa leje

Policia e Shtetit po vijon çdo ditë operacionet për të goditur fenomenin e armëmbajtjes pa leje. Përmes një postimi në rrjetet sociale ministri Balla thekson se Policia e Shtetit po godet çdo ditë armëmbajtjen pa leje.

"Policia e Shtetit po godet çdo ditë armëmbajtjen pa leje, një fenomen që mbetet gjithmonë një shembulli i keq në syrë e publikut, një shpërfillje e rëndë ndaj ligjit dhe arrogancë e hapur ndaj shoqërisë sonë. Armëmbajtja pa leje është burim potencial i krimeve të rënda kundër personit". - shkruan Balla.

Ministri Balla përgëzon operacionet e fundit të Policisë së Shtetit në Elbasan dhe Rinas të cilat arritën të sekuestrojnë armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike, si dhe ndaluan poseduesit e tyre.

"Përgëzime Policisë së Shtetit Elbasan dhe Rinas, për operacionet e fundit, duke sekuestruar armë zjarri, municion luftarak dhe lëndë narkotike, si dhe duke ndaluar poseduesit e tyre", shkruan Balla.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:59

Armë në ambientet e biznesit në Peqin, foto e të arrestuarit! Në servisin e babait të tij u gjet arma që vrau Emiljano Ramazanin

Foto: Imer Manahasa

Gazetari i Shqiptarja.com dhe Report Tv, Sokol Dema ka siguruar foton e Imer Manahasës, i arrestuar sot në Peqin pasi u gjetën armë dhe municione në biznesin e tij.

Imer Manahasa rezulton të jetë djali i Alber Manahasës, dhe vëllai i Seit Manahasës,të cilët më 28 korrik 2020 u arrestuan pasi në ambientet e biznesit të tyre, një servis makinash, u gjet arma me të cilin u ekzekutua Emiljano Ramazani me 20 korrik 2020.

Vrasjen e Emiljano Ramazanit e zbardhi i penduari i drejtësisë Nuredin Dumani. Vetë ky i fundit ishte ekzekutuar i Ramazanit dhe Runajt në korrik 2020 me porosi të Erion Allbejt.

Vrasja e Emiljano Ramazanit, i njohur me nofkën 'Rramani', dyshohet se ndodhi për larje hesapesh për drogën, pasi ai njihej si shpërndarës kokainë në qytet, ndërsa pak ditë pas vrasjes së tij u gjet i vrarë edhe miku i tij i ngushtë **Regis Runaj, 23 vjeç,** i vrarë me thikë, dhe më pas trupi i tij është hedhur buzë rrugës afër varrezave të qytetit, një rrugë qorre ku nuk kalojnë njerëz. Kjo i ka ndihmuar autorëit që të mos lënë gjurmë pasi kanë vrarë Runajn.

G.K/S.G/Shqiptarja.com

Share

G.K/S.G/Shqiptarja.com

TAG: Emiljano Ramazani | Elbasan | peqin | arma pa leje | Imer Manahasa | Albert Manahasa

Komento

Komente

titi kavajas: 25/06/2024 11:07
burgu eshte edukimi me i mire per keta tipa

Përgjigju

Ndalohet reprodhimi i kësij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
Albeaj iku nga grupi PD, çfarë duhet të bëjnë deputetët e tjerë pro Bashës?

Të ikin | Të qëndrojnë | Nuk e di

Lajme të tjera

Larg diellit në orët e pikut! Temperaturat e qershorit, përtej normales

Ronaldo Gjoshi

22 Qershor, 15:53

Basha: Nuk i lëmë demokratët në mëshirën e hallit të Berishës! Me çdo kusht do jemi në zgjedhje

21 Qershor, 21:16

Vrasja e Pjerin Xhuvanit, Ni Apel gjyqi për Arbër Papleka/ Prokurori: Qëllol 7 plumba, avokati: Ishte në kushtet e vetëmbrojtjes

Keri Banushi

21 Qershor, 11:58

Parajsa e trëndafilave në Labinot të Elbasanit (VIDEO)

21 Qershor, 11:13

'Kush e solli Doruntinën', kryeveprat e Kadaresë-vjen ndryshe në Përrenjas

Ronaldo Gjoshi

20 Qershor, 15:13

Karkaleci 'pushton' fushat e Dumresë! Fermerët: Ka bërë namin, dezinsektimi nisi me vonesë!

Ronaldo Gjoshi

17 Qershor, 16:34

Itali-Shqipëri/ Goli i Bajramit elektrizon tifozët kuq e zi në Elbasan (VIDEO)

15 Qershor, 21:53

Përrenjas/ Arrestohet 41-vjeçari, dhunoi punonjësin e shërbimit pyjor! Policia i gjen në shtëpi 400 litra naftë dhe 140 litra vaj lubrifikant kontrabande

14 Qershor, 16:06

Homazhe për Qazim Sejdinin, Veliaj: Na i bëntë me të lehta sfidat, do ta kujtoj për zemrën e bardhë

13 Qershor, 10:57

Ndahet nga jeta ish-krytari i Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejdini

12 Qershor, 13:18

Elbasan/ Vodhën automjetin dhe nuk iu binden policisë, dy personat braktisin mjetin pasi mori flakë

12 Qershor, 09:14

Elbasan/ Makina përplas biçiklistën, plagoset drejtuesi

10 Qershor, 21:25

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktësisë i kësaj faqeje